REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr 274 prot.                                                                 Gramsh, më 25/01/2021

**Niveli minimal i arsimit**:*"arsim i mesëm"*

**SHPALLJE PËR PRANIMIN NË NIVELIN BAZË TË SHËRBIMIT VENDOR TË MZSH-së, BASHKIA GRAMSH**
**(ZJARRFIKËS DHE SHOFER ZJARRFIKËS)**

Në bazë të Ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" neni 14; VKM nr. 350, datë 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"; VKM nr.520, datë 25.07.2019 "Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" Kreu III, neni 36-neni 54; Urdhërit nr.10, datë 20.01.2021 "Për shpallje vendesh të lira pune në Sektorin e Shërbimit të MZSH-së, Bashkia Gramsh" të kryetarit, Njësia e Burimeve Njerëzore, shpall procedurën e pranimit në nivelin bazë të shërbimit vendor të MZSH-së për pozicionet:

- 1(një) zjarrfikës;
- 1(një) shofer zjarrfikës;

**Afati për dorëzimin e dokumentave për**

**PRANIM NË NIVELIN BAZË:** **08.02.2021**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

1. **PUNONJËS ZJARRFIKËS,** (luftues, shpëtues, furnizues, evakuues) është personi i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut , të gjësë së gjallë dhe të pronës. Është në varësi të komandantit të shërbimit dhe mban përgjegjësi: - për marrjen dhe dorëzimin e shërbimit, - njohjen mirë të detyrës së tij funksionale, - marrjen e sinjalit të alarmit dhe veprimin me shpejtësi dhe saktësi, - pozcionimin në formacion luftimi, zbatimin e detyrave dhe të urdhërave të drejtuesit të operacionit, - bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me kolegët, si dhe me forcat e tjera operacionale, - dhënien prioritet ruajtes dhe shpetimit të jetës së njerëzve.
2. **SHOFER ZJARRFIKËS** (drejtues i automjeteve për fikjen e zjarrit dhe shpëtimin) është në

Adresa: Sheshi " Kamber Dermyshi" Rruga "10 Korriku" Web: www.bashkiagramsh.gov.al. E-mail:bashkia.gramsh2017@gmail.com

varësi të komandantit të shërbimit dhe përgjigjet për: - marrjen dhe dorëzimin e shërbimit në orarin e përcaktuar me procesverbal, - mbajtjen në gatishmëri të automjeteve zjarrfikëse, - radhën e veprimeve dhe vepron me shpejtësi e saktësi, pas marrje së sinjalit për daljen në operacion, - nisjen dhe lëvizjen për në vendngjarje sipas urdhërit të komandantit të shërbimit, - pozicionimin në vendngjarje, - rezervën hidrike të vazhdueshme dhe me prësionin e duhur, - marrjen pjese në operacionet e shpëtimit, - përgatitjen e automjetit zjarrfikës apo autoshkallë për kthim në stacion, - zbatimin e rregullave dhe sinjalistikës së qarkullimit rrugor, - larjen dhe pastrimin e automjeteve për të qënë në gatishmëri, duke bërë furnizimin me ujë, naftë, vaj...etj, - duhet të kontrollohet dhe pajiset me certifikatën mjekësore në fillim të cdo viti kalendarik nga komisioni mjekësor për aftësi për drejtim mjeti:

## 1 PRANIMI NË NIVELIN BAZË

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedure të gjithë kandidatët që nuk janë pjesë e shërbimit të MZSH-së, të cilët përmbushin kriteret e përgjithshme dhe aftësive fizike.

## 1.1 KRITERET E PËRGJITHSHME

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim në nivelin bazë si vijon:**

1. të jetë shtetas shqiptar;
2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
4. të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, policia e shtetit, apo nga institucione të tjera të administratës publike;
5. të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
6. të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
7. të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë;
8. të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
9. për gjininë mashkullore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm, ndërsa për gjininë femërore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm;
10. të jetë me peshë trupore që ti përgjigjet raportit të gjatësisë;
11. për pozicionin "shofer zjarrfikës" kandidati duhet të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C" (kanë përparësi kandidatiët të cilët janë të pajisur me leje drejtimi automjeti të grupit "D");
12. kanë prioritet kandidatët të cilët kanë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë akademisë së sigurisë ose në qëndrat e trajnimit zjarrifës dhe kanë vendbanim sa më pranë stationit të MZSH-së, Bashkia Gramsh;

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. formular aplikimi (mund të shkarkohet elektronikisht, ose mund ta tërhiqni pranë zyrës së burimeve njerëzore, Bashkia Gramsh);
2. fotokopje e kartës së identitietit;

3. dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm;
4. fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "C" dhe/ose "D";
5. certifikatë e gjëndjes gjyqësore (e-albania);
6. certifikatë familjare (e-albania);
7. vërtetim nga gjykata;
8. vërtetim nga prokuroria;
9. raport mjeko-ligjor (mjeku i familjes);
10. fotokopje e librezës së punës (nëse ka);
11. dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton që nuk është përdorues i lëndëve narkotike;
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj (nëse ka);
13. fotografi për dokument zyrtar 2 (dy) copë;

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 08.02.2021***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën ***19/02/2021*** , Njësia e Menaxhimit të Burimeve Nerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në stendën e njoftimeve në ambientet e jashtme të bashkisë dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit www.bashkiagramsh.gov.al, **listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe në rregullore, si dhe datën vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.** Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe në rregullore, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit *(nëpërmjet adresës së e-mail).*

*Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankohen të kryetari i bashkisë brenda 5(pesë) ditëve, duke filluar nga data 19.02.2021.*

## 1.5 FAZAT E KONKURIMIT

**Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së do u nënshtrohen fazave të konkurimit si më poshtë:**

a) testimi me shkrim;

b) testimi i aftësive fizike;

c) intervistë me gojë dhe testim psikologjik

d) verifikim përfundimtar i aplikantit;

## a.) FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
- Rregulloren nr.520, datë 25.07.2019 "Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";

Lista e kandidatëve të kualifikuar për fazën e testimit fizik, që kanë marrë mbi 70(shtatëdhjetë) pikë në testimin me shkrim, do të publikohet më datë 03.03.2021 në ambientet e jashtme të bashkisë dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit www.bashkiagramsh.gov.al

**Në të njëjtën ditë do të publikohet edhe data, vendi dhe ora e saktë ku do të zhvillohet testimi fizik, intervista me gojë dhe testimi psikologjik.**

Kandidatët që nuk janë kualifikuar për fazën e testimit fizik, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit *(nëpërmjet adresës së e-mail)*, kanë të drejtë të riaplikojnë për t'u pranuar në shërbimin e MZSH-së, me shpalljen e radhës së vendeve të lira.

## b.) AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI FIZIK

Kandidatët do të vlerësohen ne lidhje me:

I. peshën dhe gjatësinë trupore;
II. përgatitjen fizike (testin e vrapit dhe testin e pergjithshëm të muskujve);

**shënim**: *kandidati duhet të paraqitet në ditën e testimit me uniformë të rregullt sportive*

Lista e kandidatëve të kualifikuar që kanë marrë mbi 60 (gjashtëdhjetë) pikë në testimin fiizk , do të publikohet më datë 05.03.2021 në ambientet e jashtme të bashkisë dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit www.bashkiagramsh.gov.al.

## c.) AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA ME GOJË DHE TESTIMI PSIKOLOGJIK

Kandidatët do të vlerësohen ne lidhje me:

I. aftësitë për të menduar, analizuar, komunikuar dhe për të marrë vendime;
II. aftësitë për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;
III. përshtshmërinë për t'u bërë punonjës i shërbimit të MZSH-së;

Lista e kandidatëve të kualifikuar që kanë marrë mbi 50 (pesëdhjetë) pikë në intervistën me gojë dhe testimin psikologjik, do të publikohet më datë 05.03.2021 në ambientet e jashtme të bashkisë dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit www.bashkiagramsh.gov.al.

## d.) VERIFIKIMI DHE VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I KANDIDATËVE

Rezultati përfundimtar i kandidatëve do të përcaktohet si shumatore e rezultateve si më poshtë:

a) testimi me shkrim, intervista me gojë dhe testimi psikologjik përbëjnë në total 50% të rezultatit të përgjithshëm;
b) testimi fizik përbën në total 50% të rezultatit të përgjithshëm;

Lista përfundimtare e kandidatëve sipas pikëve të grumbulluara në rend zbritës, do të publikohet më datë 08.03.2021 në ambientet e jashtme të bashkisë dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit www.bashkiagramsh.gov.al.

Afati për ankim është 5(pesë) ditë duke filluar nga data 08.03.2021, pranë drejtorisë së burimeve njerëzore të institucionit.

P/Drejtorinë e Burimeve Njerëzore
Joana Zani

P/Sektorin e Shërbimit të MZSH-së
Ilir Llapushi

KRYETARI
Klodian TAÇE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH-SË

**FLETA E PRANIMIT PËR TESTIM**

FOTOJA E APLIKANTIT

**Kodi i aplikantit**

______________________

**Emri** ______________________

**Atësia** ______________________

**Mbiemri** ______________________

**Adresa** ______________________

**Data e testimit** ______________________

**Ora** ______________________

**Vendi** ______________________

**Aplikanti**

(______________________)

Emri, atësia, mbiemri

**Nënshkrimi**

**Punonjësi i Burimeve Njerëzore**

(______________________)

(emri/mbiemri/firma)

*Shënim: Fotografia e aplikantit duhet të vuloset me vulës e bashkisë*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH-SË

Nr._____prot                                                                 Datë ___/___/2021

## 1. <u>INFORMACION PERSONAL</u>

<table>
<tr><td colspan="2">Mbiemri:</td><td colspan="2">Emri:</td><td colspan="2">Atësia:</td></tr>
<tr><td colspan="3">Adresa:</td><td>Nr. i telefonit</td><td colspan="2">Adresa e e-mail-it:</td></tr>
<tr><td>Datëlindja:<br>Data/muaji/viti</td><td>Mosha</td><td>Vendlindja</td><td>Gjatësia</td><td>Pesha</td><td>Gjinia:<br>Mashkull ☐<br>Femër ☐</td></tr>
<tr><td colspan="3">Gjëndja civile:<br>Martuar ☐ I/e ve ☐ Beqar ☐<br>Divorcuar</td><td>Jeni shtetas shqiptar?<br>Po ☐<br>Jo ☐</td><td colspan="2">Keni leje drejtimi të kategorisë "B" apo më sipër?<br>Po ☐ Nr. i lejes së drejtimit:<br>Jo ☐</td></tr>
</table>

**<u>Keni ndonjë të afërm të punësuar aktualisht në Shërbimin Zjarrfikës?</u>**

<table>
<tr><td colspan="4">Po ☐ Nëse "Po", plotësoni informacionin e mëposhtëm<br>Jo ☐</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Mbiemri</td><td>Emri</td><td>Atësia</td><td>Lidhja që ka me ju</td><td>Grada dhe pozicioni në shërbimin e MZSH-së</td><td>Vendi ku kryen detyrën</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

**<u>Firma e aplikantit</u>**

2. **<u>BANESAT</u> (Rendisni adresat në të cilat keni banuar gjatë 10 viteve të fundit. Filloni me adresën ku jetoni aktualisht. Përfshini edhe adresat ku keni jetuar përkohësisht)**

| | | |
|---|---|---|
| Nga: Deri:<br><br>Muaji/Viti<br>Aktualisht | Adresa: | |
| Nga: Deri:<br><br>Muaji/Viti<br>Aktualisht | Adresa: | Arsyeja e largimit: |
| Nga: Deri:<br><br>Muaji/Viti<br>Aktualisht | Adresa: | Arsyeja e largimit: |
| Nga: Deri:<br><br>Muaji/Viti<br>Aktualisht | Adresa: | Arsyeja e largimit: |

3. **<u>ARSIMI</u>**

**<u>Shkollat e mesme që keni ndjekur (Rendisni shkollën e fundit që keni ndjekur, të parën)</u>**

| Emri i shkollës | Fshati/Qyteti | Periudha Kohore | Diplomuar |
|---|---|---|---|
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ |
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ |
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ |

<u>Firma e aplikantit</u>

**Universitetet që keni ndjekur (Rendisni universitetin e fundit që keni ndjekur, të parin)**

| Emri i Universitetit | Qyteti | Periudha Kohore | Diplomuar | Diplomuar për | Specialiteti |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ | | |
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ | | |
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ | | |

**Shkollat profesionale që keni ndjekur (Rendisni shkollën që keni ndjekur, të parën)**

| Emri i shkollës | Qyteti | Periudha Kohore | Diplomuar | Specialiteti |
|---|---|---|---|---|
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ | |
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ | |
| | | | Po ☐<br>Jo ☐ | |

4. PËRVOJA E PUNËS (Rendisni punën tuaj të fundit, të parën)

| Data | Emri i punëdhënësit | Adresa dhe nr. i telefonit | Pozicioni | Arsyeja e largimit |
|---|---|---|---|---|
| Nga: Deri:<br><br>Data/Muaji/Viti<br>Data/Muaji/Viti | | | | |
| Nga: Deri:<br><br>Data/Muaji/Viti<br>Data/Muaji/Viti | | | | |
| Nga: Deri:<br><br>Data/Muaji/Viti<br>Data/Muaji/Viti | | | | |

Firma e aplikantit

## 5. SHËRBIMI USHTARAK

Keni shërbyer ndonjëherë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë?

| |
|---|
| Po ☐ Nëse "Po", plotësoni informacionin e mëposhtëm |

| Jo ☐ | | | |
|---|---|---|---|
| Forca në të cilën keni shërbyer | Periudha kohore | Numri i repartit | Vendndodhja |
| Tokësore ☐ Grada ☐<br>Detare ☐<br>Arjërore ☐ | Nga: Deri:<br><br>Data/Muaji/Viti<br>Data/Muaji/Viti | | |

## 6. VEPRIMTARIA KRIMINALE

Jeni dënuar ndonjëherë për ndonjë krim?

| Po ☐ Nëse "Po", plotësoni informacionin e mëposhtëm<br>Jo ☐ | | | |
|---|---|---|---|
| Lloji i Krimit | Data e dënimit | Vendndodhja | Gjykata |
| | | | |

Jeni arrestuar ndonjëherë për një krim krim, pavarësisht nëse nuk jeni dënur?

| Po ☐ Nëse "Po", plotësoni informacionin e mëposhtëm<br>Jo ☐ | | |
|---|---|---|
| Lloji i Krimit | Data e arrestimit | Vendndodhja |
| | | |

Firma e aplikantit

Jeni dënuar ndonjëherë kur keni qenë i mitur?

| Po ☐ Nëse "Po", plotësoni informacionin e mëposhtëm<br>Jo ☐ | | |
|---|---|---|
| Lloji i Krimit | Data e dënimit | Vendndodhja |
| | | |

A jeni aktualisht nën ndjekje penale apo prisni që kjo të fillojë së shpejti?

| Po ☐ Nëse "Po", plotësoni informacionin e mëposhtëm<br>Jo ☐ | | |
|---|---|---|
| Lloji i Krimit | Data e arrestimit | Vendndodhja |
| | | |

7. GJUHË TË HUAJA

Rendisni të gjitha gjuhët e huaja që njihni

| Gjuha | Lexon | Shkruan | Flet | Kupton |
|---|---|---|---|---|
| | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ |
| | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ | Sh. mirë ☐<br>Mirë ☐<br>Disi ☐<br>Dobët ☐ |

8. REFERENCAT

Rendisni emrat e tre personave që ju kanë njohur gjatë 5 viteve të fundit (Mos përfshi emrat e personave që ju janë përmendur më sipër në këtë formualr aplikmi)

| Mbiemri | Emri | Atësia | Adresa dhe nr. i telefonit |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Firma e aplikantit